VENDIM
Nr.88, datë 13.12.2006

PËR DHËNIEN E LICENCËS PËR IMPORTIN E ENERGJISË ELEKTRIKE "GSA" SHPK

Në mbështetje të nenit 9 nenit 13 pika 1 germa "d", nenit 15 të ligjit nr.9072, datë 22. 5.2003 "Për sektorin e energjisë elektrike", i ndryshuar, vendimit të Bordit të Komisionerëve të ERE-s nr.37, datë 9.7.2004 "Rregullorja për procedurat e licencimit", nenet 4 pika 1 germa "f"dhe 5 pika 1, Bordi i Komisionerëve të ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 13.12.2006, pasi shqyrtoi kërkesën e paraqitur nga GSA sh.p.k. për pajisjen me licencë për aktivitetin e importit të energjisë elektrike,

VENDOSI:

1. Dhënien e licencës për importin e energjisë elektrike "GSA" sh.p.k. për periudhën 27.1.2007–26.1.2008.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI I ERE-s
Bujar Nepravishta